

Te dhena te pergjithshme per shoqerine

Shoqeria I.D.K. Konstruksion shpk eshte e krijuar me Vendim te Gjykates nr.41124, date 05/07/2004, me Kapital te nenshkruar 100.000 leke.

Kapitali aktual i shoqerise eshte 250.000.000 leke, i perbere teresisht ne para, dhe zoteruar 100% nga ortaku i vetem Z.Barjam Dalipi.

Objekti i aktivitetit te shoqerise eshte: Sinjalistike rrugore vertikale, horizontale, siguri rrugore, ndriçuese dhe jondriçuese, studim, projektim, prodhim, montim, tregtim dhe zbatim te tyre. Import-eksport, tregti me shumice dhe pakice te sinjalistikes rrugore, targa prokate, veshjeve te punes, paisje dhe veshje per parandalimin e aksidenteve, per sigurimin teknik ne pune, vegla pune te pajisjeve dhe pjeseve industriale, telekomunikacioni, pajisje elektrike etj. Aktivitet ne fushen e ndertimit (ndertimet civile dhe industriale, rikonstruksione dhe mirembajtje civile, industriale etj.) rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tranvaje, metro, punime nentoksore, ura e vepra arti. Rrjete inxhinierike per ujesjellesa, gazsjellesa linja tensioni te larte e te ulet, telefoni, ndriçim, punime te inxhinierise se mjedisit etj. Prodhimi, tregtim i farave, fidaneve etj, Sherbime profesionale per zbatim dhe projektim lidhur me pyje dhe kullota.

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga Zaja, Koder Berxulle, Autostrada Tirane-Durres, Km.12, Tirane.

Shoqeria administrohet nga administrator i vetem Z.Gramoz Dalipi.

Shenimet shpjeguese te Pasqyrave Financiare

Pasqyrat e Politikave Kontabel për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2018

Bazat e përgatitjes

Deklarimet financiare te bashkengjitura te shoqerise IDK-Konstruksion.shpk jane pergatitur ne baze te regjistrimeve kontabel te mbajtura konform Ligjit 9228, date 29.04.2004, "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrat Financiare te fund vitit jane paraqitur ne formatin e paraqitur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara ne fuqi (SKK2).

Sipas parimeve te kontabilitetit ne Shqipëri deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Pergatitja e pasqyrave Financiare ne perputhje me kerkesat e SKK, kerkon perdorimin e disa vlersimeve kontabel te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe manaxhimi i Shoqerise te jape gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabel te saj. Fushat te cilat kerkojne nje shkalle te larte ose kompleks te gjykimit ose ato per te cilat vlersimet apo supozimet jane te rendesishme per hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenime.

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese njehen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese.

Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekonomike raportuese, regjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili perfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen ne menyre te kompjuterizuar, me ane te nje programi te kontabilitetit.

Deklarimet financiare jane shprehur ne leke, e cila eshte monedha shqiptare.

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

Politikat kryesore Kontabël

i. Instrumentat financiare

Kompania IDK-Konstruksion shpk ka vetem instrumenta financiare jo derivative, perfshire dhe kerkesa nga kliente dhe kerkesa te tjera, mjete likuide dhe te ngjashme me to, furnitore dhe te tjera detyrime.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen, fillimisht, me vleren e drejte plus çdo kosto te drejtperdrejte transaksioni te lidhura me to, pervec atyre te pershkruara me poshte. Ne vazhdim te njohjes fillestare instrumentat financiare vleresohen si me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese kompania eshte pale ne kushtet e kontrates. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat e Kompanise mbi rrjedhat e ardhshme te parase te gjeneruara nga aktivi financiar kane mbaruar ose nese kompania i transferon aktivet financiare nje pale te trete pa mbajtur te drejtat e kontrollit ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet nga aktivi. Detyrimet financiare nuk njihen me nese detyrimet e Kompanise te specifikuara ne kontrate mbarojne afatin ose shlyen ose anulohen.

Mjetet Monetare

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar afatshkurtera jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar, pra me vleren e koston se tyre minus provizionet e krijuara per renie ne vlere. Provizione te lejuara mund te llogariten, per shumat e vleresuara si te rikuperueshme, ne fitim humbje kur egziston nje evidence objektive qe keto kerkesa jane zhvlersuar me pare.

Detyrime te pagueshme

Detyrimet per tu paguar dhe te tjera detyrime paraqiten me vleren e drejte te tyre dhe me pas maten me vleren e tyre te amortizueshme.

Huate bankare dhe te tjera

Ne vazhdim te njohjes fillestare; huate bankare dhe te tjera paraqiten me kosto te amortizueshme duke njohur cdo diference midis koston dhe vleres se rikuperueshme ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve gjate periudhes se huamartjes ne baze te nje interesi efektiv.

Te tjera

Te tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto te amortizueshme duke perdorur metoden e interesit efektiv, minus cdo humbje nga zhvlersimi.

Kontabilizimi i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare sqarohet ne pikat me poshte.

ii. Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare te tyre Shoqeria vlereson inventarin me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te realizueshme.

Inventaret i nenshtrohen testit te zhvlersimit ne daten e mbylljes se bilancit. Shuma e Zhvlersimit njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve atehere kur ka faktore objektive qe tregojne qe inventaret jane zhvlersuar.

iii. Aktivet Afatgjata Materiale

Ne bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvlersimi.

Aktivete Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdrejta qe lidhen me sjelljen e aktivitetit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Metoda per llogaritjen e amortizimit per keto aktive eshte metoda lineare e cila merr ne konsiderate jeten e dobishme ekonomike.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashte perdorimit percaktohen nga krahasimi i perfitimeve me vleren e tyre kontabel. Keto perfshihen ne pasqyren e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.

iv. Njohja e te ardhurave

Te ardhurat jane hyrje bruto te perfitimeve ekonomike gjate periudhes, te cilat vijne nga veprimtaria e zakonshme e nje njesie ekonomike kur keto hyrje sjellin rritje ne kapitalin neto, pervec rritjeve qe lidhen me kontributet nga pjesmarresit ne kapital. Te ardhurat e perfshijne vetem vleren e drejte te perfitimeve ekonomike te marra dhe ato qe jane per t'u marre nga shitja e mallrave dhe sherbimeve gjate aktivitetit te zakonshem te kompanise.

Te ardhurat perfshijne shumat neto pa perfshire shumat e mbledhura per llogari te paleve te treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe sherbimeve, si dhe tatimi i vleres se shtuar, te cilat nuk jane perfitime ekonomike qe hyjne ne njesine ekonomike dhe sjellin rritje te kapitalit neto.

Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat jane njohur kur ndryshimi i pronesis se bashku me riskun qe vjen nga ky ndryshim, jane transferuar tek bleresi.

v. Shpenzimet

Shpenzimet jane njohur mbi bazen e te drejtave te konstatuara.

vi. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja e aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huate, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvlersimet a aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarrjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

vii. Tatimi mbi fitimin aktual

Shpenzimi (e ardhura) tatimore permban shpenzimin tatimor aktual (te ardhuren tatimore aktuale). Shpenzimet qe lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne ditën e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese.

viii. Transaksionet me monedhat e huaja

(a) Monedha e perdorur dhe raportuese

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njestia ekonomike vepron (monedha ne perdorim).

Pasqyrat e konsoliduara financiare raportohen ne Leke shqiptar (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe raportuese e Kompanise.

(b) Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Shenim A.1 - Aktivet monetare

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Banka (llog. rrjedhese ne leke)	415,947	109,235
Banka (llog. rrjedhese ne euro)	100,691	62,291
Banka (llog. rrjedhese ne USD)	7,889	
Arka	62,373	
Total	586,900	171,526

Shenim A.2 - Të drejta të arkëtueshme

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Nga aktiviteti i shfrytëzimit (Kliente)	351,748,155	461,212,220
Tatim mbi fitimin (teprice kreditore)	3,669,681	7,475,412
Detyrime taksa dogane mbipag	184,226	190,890
Debitore Bashkia Tirane, taksa paguar 2 here	63,000	63,000
Debitore te tjere (pagesa garancish dhe komisionesh te kthyeshme)		1,123,598
Debitore per hua te dhena	910,000	50,000
Shpenzime te periudhave te ardheshme		
Total	356,575,062	470,115,120

Shenim A.3- Inventarët

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	191,757,553	106,748,909
Prodhim ne proces	946,576	-
Produkte te gatshme		-
Mallra		-
Inventar i imet	9,192,975	7,479,726
Parapagime per furnizime materiale e sherbime	5,298,106	32,991,183
Total	207,195,210	147,219,818

Shenim A.4. Aktive Financiare

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Huadhenie	117,302,342	1,200,000
Totali	117,302,342	1,200,000

Shenimi A.5.1 Aktive afatgjata materiale

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Toke	1,344,000	1,344,000
Ndertime ne proces		
ndertime dhe instalime te tjera	59,858,839	59,858,839
Makineri,paisje, vegla pune	26,874,768	13,604,191
Mjete transporti	15,573,945	7,691,068
Pajisje kompjuterike	3,685,380	4,100,644
Pajisje Zyre	2,474,698	2,591,076
Aktive te tjera materiale	35,003	43,754
Total	109,846,633	89,233,572

Shenim A.5.2 Aktive afatgjata jomateriale

	31.12.2018	31.12.2017
Shpenzime te zhvillimit	1,481,691	1,481,691

Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale jane paraqitur me vleren e mbetur ne date 31.12.2018

Shenim A.6-Tituj te Huamarrjes

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Pjesa afatshkurter e huamarrjes	45,204,597	119,252
Total	45,204,597	119,252

Shenim A.7-Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Furnitore per mallra e sherbime	315,959,316	326,136,553
Total	315,959,316	326,136,553

Shenim A.8- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Të pagueshme ndaj punonjësve	1,865,650	3,059,780
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	1,697,558	704,002
Total	3,563,208	3,763,782

Shenim A.9- Detyrime tatimore

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
TVSH per tu paguar	560,256	4,132,781
Tatim ne burim	7,500	1,500
Tatim mbi fitimin		
Total	567,756	4,134,281

Shenim A.10. Të tjera të pagueshme

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Detyrime per tu paguar	2,550,000	12,047,385

Shenim A.11- Arkëtime në avancë për porosi

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Arkëtime në avancë për porosi	65,949,271	37,957,793

Arkëtime në avancë për porosi perfaqesojne parapagime te marra nga klientet per te cilat eshte prere fatura paradhenie, dhe sherbimi do tu kryhetne periudhat ne vazhdim.

Shenim A.12- Tituj te huamarrjes

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Huamarrje afatgjate	66,341,914	66,341,914
Totali	66,341,914	66,341,914

Shenim A.13-Të ardhura të shtyra afatgjata

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Te ardhura te shtyra Grant (dhurate Vodafone)	81,327	108,436
Total		

Granti perfaqesohet nga vlera e te ardhurave te cila do te rimerren ne vitet e ardhshme dhe eshte e barabarte me vleren e mbetur te asetete dhuruar nga nje pale e trete.

Shenim A.14- Totali i kapitalit

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Kapitali	250,000,000	22,000,000
Rezerva ligjore	7,600,000	108,914,774
Rezerva te tjera		97,546,441
Fitimi/humbja e vitit financiar	35,170,449	30,351,116
Total	292,770,449	258,812,331

Ne vitin 2018 sipas vendimit te ortakut te vetem te shoqerise u vendos qe fitimi i vitit 2017 ne shumen 30.351.116 leke te perdorej per rritjen e rezervave ligjore ne shumen 3.200.000 leke, zmadhim kapitali ne shume 25.938.785 leke dhe shperndarje dividend ne shumen 1.212.331 leke

Shenim B.1 - Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Emertimi	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Shitjet neto	551,692,708	455,987,513

Ne kete ze jane perfshire te ardhurat nga shitja e materialeve dhe sherbimeve te ofruara nga shoqeria.

Shenim B.2 - Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Emertimi	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Të ardhura nga shitja e AQ		125,000
Totali	-	125,000

Te ardhurat sipas bilancit paraqiten me vlere me te vogel se te ardhurave sipas FDP-ve te TVSH ne shumen 579.860.855 leke. pasi gjate vitit jane faturuar parapagimet, te ardhurat e te cilave nuk i takojne periudhes, si dhe disa nga te ardhurat e shtyra te vitit 2017, pas realizimit te sherbimit kane kaluar ne te ardhura te periudhes 2018. Diferenca midis tyre, e paraqitur si diference e te ardhurave te shtyra ne zeri "Arketime ne avance per pororsi" paraqet diferencen e te ardhurave sipas Pasqyrese se te Ardhurave dhe Shpenzimeve dhe deklarimit sipas FDP-ve. duke qene se shumica e parapagimeve paraqitet ne monedhe te huaj rezulton e vogel si efekt kursi i kembit. Ne shenimin si me poshte paraqitet analitke kjo diference:

Shenime per diferencen e te ardhurave	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Te ardhurat sipas pasqyres se te Ardhurave dhe Shpenzimeve	551,692,708	460,113,764
Te ardhura sipas FDP-ve	579,860,855	449,987,302
Diferenca	(28,168,147)	10,126,462
Te ardhura te shtyra ne fillim te periudhes	37,957,793	48,124,077
Te ardhura te shtyra ne fund te periudhes	65,949,271	37,957,793
Ndryshimi te ardhura te shtyra	(27,991,478)	10,166,284
Diferente kursi	(176,669)	(39,822)
Totali	(28,168,147)	10,126,462

Shenim B.3- Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Emertimi	<u>31.12.2018</u>	<u>31.12.2017</u>
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	408,226,028	356,282,286
Të tjera shpenzime (kosto e sherbimeve)	2,754,046	4,166,667
Sherbime zingimi	2,377,075	
	<u>413,357,149</u>	<u>360,448,953</u>

Shenim B.4- Shpenzime të personelit

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Pagat e personelit	32,656,402	22,889,142
Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetsore	5,357,056	3,772,758
Total	38,013,458	26,661,900

Shenim B.5- Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Amortizimi Makineri,paisje, vegla pune	3,912,309	3,068,593
Amortizimi Mjete transporti	1,816,146	1,570,656
Amortizimi Pajisje kompjuterike	1,066,168	997,256
Amortizimi Pajisje Zyre	626,923	506,525
Amortizimi Aktive te tjera	8,751	10,938
Shpenzime amortizimi	15,781	
Shpenzime amortizimi te inventarit te imet	1,072,106	
Total	8,518,184	6,253,968

Shenim B.6- Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Qira	2,154,146	140,053
Blerje energji dhe uje	268,770	312,914
Mirembajtje dhe riparime automjeti dhe makineri e paisje pune	1,647,309	996,333
Siguracione	784,372	544,783
Shpenzime per karburant	8,979,607	3,170,272
Shpenzime kons. Financiare e te ngjashme	973,093	1,524,324
Shpenzime per dieta	2,028,450	1,332,123
shpenzime per pritje percjellje	622,227	141,145
Shpz.postare e telekom.	536,629	664,274
Shpenzimet per situacionet nenkontraktore	3,521,666	
Shpenzime te tjera (noteri,inxhinierike, financiare etj)	4,280,068	4,968,219
Shpenzime te tjera	13,116,613	8,541,346
VI kont e AQ te shitura	-	55,077
Taksa dhe tarifa vendore	689,037	601,503
Shpenzime tatime dhe taksa te tjera	851,495	335,250
Sherbime bankare	988,391	
Shpenzime per sherbime te ceshtjeve te punes	372,836	628,983
Shpenzime per sherbime doganore	519,053	255,500
Shpenzime per pagesa te detyrimeve per mjete	206,835	386,492
Total	42,540,597	24,598,591

Shenim B.7- Te ardhura të tjera

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Te ardhura nga granti (rimarrje amaortizimi)	33,398	36,145
Te ardhura nga interesat	44,677	4,014,530
Fitimi nga kursi i kembimit	1,434,403	121,268
Totali	1,512,478	4,171,943

Shenim B.8- Shpenzime financiare

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Shpenzime per interesa	(1,342,760)	(899,937)
Humbje nga kursi i kembimit	(8,025,119)	(5,308,222)
Sherbime bankare		
Total	(9,367,879)	(6,208,159)

Shpenzime te pazbritshme

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Shpenzime per gjoba dhe demshperblime	103,140	1,980,553
Shpenzime amortizimi te panjohura		
Shpenzime te panjohura	72,066	318,354
Total	175,206	2,298,907

Shenim B.9- Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Emertimi	31.12.2018	31.12.2017
Rezultati financiar	41,407,917	36,112,885
Shpenzime gjoba e pa fature (te panjohura)	175,206	2,298,907
Rezultati fiskal	41,583,123	38,411,792
Tatim mbi fitimin	6,237,468	5,761,769

Hartoi

Lindita Kikino

Kontabel i Miratuar

Lindita Kikino
[Signature]

Miratoi

Gramos Dalipi

Administratori i shoqerise

D.K. Konstruksion shpk

